



**Mbledhja e mbeturinave derë më
derë në Bashkinë Lezhë:**

**Një hap drejt mjedisit të pastër
dhe të organizuar**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige



HELVETAS

#Bashkia Lezhë; menaxhimi i mbetjeve urbane; Mbledhje derë më derë; Orari i mirë përcaktuar; Praktika e mirë; Bashkëpunimi; Pilotimi dhe vlerësimi; Përfituesit; Ndikimi dhe përfitimet afatgjata; replikimi

18 qershor 2024

Emri i autorit(ve)

Kryetari i Bashkisë dhe stafi i bashkisë (Pjetrin Ndreu – Kryetar; Ermal Pacaj – Nënkyetar; Elson Frroku – Nënkyetar (ish -Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik); Indrit Torba – Specialist i Drejtorisë së Shërbimeve Publike (Supervizor).

Sqarim

Ky dokument u përgatit nga stafi i Bashkisë Lezhë me asistencë nga Projekti “Bashki të Forta”, i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe i Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e SDC-së, Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Përmbajtja

Përmbledhje	4
Vlerësimi si praktikë e mirë	5
Sfida / problemi / situata fillestare	6
Praktika e mirë	7
Përshkrim i përgjithshëm i zgjidhjes	7
Zbatimi hap pas hapi dhe afatet kohore.....	8
Palët e interesuara dhe partnerët	8
Përfituesit	9
Mjetet dhe burimet	10
Buxheti / Kostot	10
Mbështetje nga institucione/projekte/konsulentë të jashtëm	11
Ndikimi.....	11
Qëndrueshmëria.....	12
Mësime të nxjerra.....	12
Aspekte që bien në sy në veçanti:	13
Sugjerime specifike për bashkitë e tjera:.....	13
Lidhje të përdorshme	13

Përmbledhje

Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve urbane në bashkinë Lezhë kryhet përmes kontratave publike me kompani private të specializuara për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve. Trajtimi i mbetjeve bëhet në Landfillin e Bushatit. Bashkia ka edhe një skuadër pastrimi për zonat e pa mbuluara me kontratë, sidomos gjatë sezonit turistik, për pastrimin e rrugëve e plazheve publike. Çështje shqetësuese ka qenë hedhja e mbeturinave në çdo kohë, gjë që çonte në tejmbushjen e kontenerëve, duke shkaktuar probleme për qytetarët dhe bizneset.

Qyteti i Shëngjinit është një nga destinacionet kryesore turistike në veri të Shqipërisë, me një fluks shumë të lartë turistik, kryesisht gjatë periudhës maj-tetor. Investimet në pasuri të paluajtshme kanë bërë së fundmi, që ky fluks të rritet edhe në pjesën tjetër të vitit. Kuzhina mesdhetare dhe produktet e peshkut ngelen atraksion i rëndësishëm. Mbetjet ushqimore zënë një përqindje të lartë të sasisë së mbetjeve të grumbulluara. Bashkia Lezhë zgjodhi metodën e mbledhjes së mbeturinave derë më derë dhe aty ku kjo metodë nuk mund të zbatohet, hedhjen e tyre në orare të caktuara. Praktika u zbatua në NJA Shëngjin, u pranua nga komuniteti dhe po planifikohet të përsëritet në njësi të tjera të bashkisë.

Zgjidhjet e aplikuara në NJA Shëngjin konsiderohen një praktikë e mirë, pasi ishin përgjigje efikase për problematika të kahershme për zyrtarët e bashkisë dhe qytetarët e bizneset.

Vlerësimi si praktikë e mirë

Ka disa elementë që kontribuuan veçanërisht në vlerësimin e kësaj praktike, si një praktikë e mirë:

- **Efektiviteti në menaxhimin e mbetjeve urbane:** Praktika ka reduktuar tejmbushjet dhe ka përmirësuar përdorimin e resurseve në trajtimin dhe transportin e mbeturinave.
- **Përfshirja e komunitetit:** Përmes fushatave të edukimit dhe informimit, bashkia ka siguruar mbështetjen dhe bashkëpunimin e qytetarëve dhe biznesit lokal, duke i bërë ata partnerë të rëndësishëm në këtë proces.
- **Përfitimet mjedisore:** Ndikim pozitiv në mjedis duke reduktuar ndotjen dhe përhapjen e aromave të pakëndshme nga kontenierët e tejmbushur. Përmirësimi i pamjes së qytetit dhe zonave turistike është një aspekt tjetër pozitiv mjedisor i kësaj praktike.
- **Kostot e reduktuara dhe efikasiteti administrativ:** Janë ulur kostot administrative për menaxhimin e mbeturinave. Përdorimi i orareve të caktuara dhe koordinimi i mirë i operacioneve ka rritur efikasitetin dhe ka lehtësuar ngarkesën për administratën lokale.
- **Risia dhe modeli i replikimit:** Mbledhja derë më derë e mbetjeve në një shkallë të tillë (gjithë zona turistike NJA Shëngjin) nuk është zbatuar në asnjë bashki tjetër. Anketimet tregojnë se kënaqësia e qytetarëve është rritur në mbi 78% të qytetarëve. Planifikimi dhe përgatitja e kësaj praktike për të qenë e përshtatshme për replikim në zona të tjera dhe bashki të ngjashme, tregon një qasje të qëndrueshme dhe strategjike për menaxhimin e mbeturinave. Ky model i replikimit potencialisht mund të përdoret edhe në kontekste të tjera urbane dhe rurale.

Sfida / problemi / situata fillestare

Menaxhimi joefikas i mbetjeve urbane në NJA Shëngjin, bënte që 77 kontejnerë të ndarë në 35 pika të tejmbusheshin, duke krijuar pika ndotjeje mjedisore (rreth 25-30 m² rreth çdo pike), duke afruar grumbullues të paligjshëm të mbetjeve, si dhe kafshë endacake. Kjo situatë shkaktonte pakënaqësi tek banorët, bizneset dhe turistët, duke ndikuar negativisht në higjienën dhe cilësinë e jetës në zonë.

Zona ka 84 hotele me mbi 3000 shtretër, 139 bare dhe restorante, 250 biznese të vogla, qindra shtëpi private që jepen me qira gjatë sezonit të plazhit. 12,798 banorëve u shtohen mbi 50,000 turistë që vizitojnë Shëngjinin. Kananët e vendosur përgjatë Shëtitorës Uillon krijojnë një pamje të pakëndshme dhe pabarazi mes bizneseve. Fillimi i kësaj praktike solli efekte pozitive.

Heqja e kakanëve përgjatë Shëtitorës Uillon dhe vendosja e 12 stacioneve me nga tre kosha të vegjël riciklimi për kalimtarët, të ndara në tre rryma mbetjesh, përmirësoi ndjeshëm cilësinë e pastrimit, ndërgjegjësimin dhe pamjen vizuale të zonës.

Mbledhja e mbetjeve derë më derë dhe hedhja në orare të caktuara solli përmirësime të dukshme. Anketimet tregojnë një rritje të kënaqshmërisë së qytetarëve në mbi 78% dhe një ulje mbi 65% të ankesave për menaxhimin e mbetjeve.

Praktika e mirë

Përshkrim i përgjithshëm i zgjidhjes

Objektivat e Bashkisë ishin: (i) përmirësimi i cilësisë së mjedisit; (ii) reduktimi i përhapjes së mbeturinave, pranisë së aromave të pakëndshme si dhe të qenve të rrugës. Konsultimi me një grup ekspertësh dhe studimi i praktikave të mira nga vendet e rajonit e solli Bashkinë në vendimin se **shkurtimi i kohës nga hedhja e mbeturinave deri në boshatisjen e kontenierëve ishte çelësi i zgjidhjes së problemit**. Kjo përfshinte:

- Mbledhjen e mbetjeve derë më derë në zonat ku kjo ishte e realizueshme.
- Hedhjen dhe boshatisjen e kontenierëve në orare të caktuara.
- Pilotimin fillimisht të praktikës në 1-2 Njësi Administrative.

Monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm u siguruan nga specialistët e bashkisë, të cilët planifikojnë replikimin e saj në të gjithë territorin e bashkisë. Palët e interesuara (banorët, bizneset dhe turistët) u nxitën përmes fushatave sensibilizuese dhe anketave, për të dhënë mbështetje dhe bashkëpunim. Fokusi ishte në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve. Zgjidhja përfshinte heqjen e kontenierëve nga hapësirat publike dhe zëvendësimin e tyre me mbledhjen derë më derë dhe kontenierë të vegjël për kalimtarët, të ndarë në tre rryma mbetjesh. Kjo përmirësoi cilësinë e pastrimit dhe pamjen vizuale të zonës. Sfidat u trajtuan përmes një qasjeje të strukturuar që përfshinte analizën e situatës fillestare, konsultimin me ekspertë, dhe zbatimin pilot të praktikës së re në njësi të caktuara administrative. Ky proces u shoqërua me monitorim të vazhdueshëm dhe përmirësim të praktikës bazuar në përgjigjen e komunitetit. Rezultatet e praktikës ishin si më poshtë:

Rezultate të matshme:

- Ulja me mbi 65% e numrit të ankesave për menaxhimin e mbetjeve.
- Rritja e kënaqshmërisë në mbi 78% të qytetarëve.
- Përmirësimi i cilësisë së pastrimit dhe higjienës në zonat publike.
- Reduktimi i ndotjes mjedisore rreth kontenierëve me eliminimin e pikave të ndotjes.

Rezultate të tjera:

- Përmirësimi i perceptimit të qytetarëve dhe turistëve për cilësinë e jetës dhe ambientit në Shëngjin.
- Rritja e kënaqësisë së bizneseve dhe barazia mes tyre për shkak të heqjes së kontenierëve nga hapësirat publike.
- Krijimi i një ambienti më tërheqës dhe të pastër për turistët, duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.

Zbatimi hap pas hapi dhe afatet kohore

Zbatimi i zgjidhjes përfshiu disa hapa, që paraqiten më poshtë:

- **Identifikimi i problemit (1 muaj)** Specialistët e bashkisë identifikuan problemin e hedhjes së pakoordinuar të mbeturinave, që shkaktonte tejmbushje, si dhe zbrazjen e kontenierëve.
- **Studimi dhe analiza (2 muaj)** Bashkia dhe ekspertët realizuan një studim analizë të situatës dhe praktikave më të mira nga bashkitë e rajonit dhe më gjerë.
- **Përcaktimi i planit të veprimit (1 muaj)** U vendos që mbeturinat të grumbulloheshin derë më derë dhe të hidheshin në kontenierë në orare të caktuara, të koordinuara me oraret e zbrazjes nga kompania e kontraktuar.
- **Pilotimi në NJA Shëngjin (6 muaj)** Projekti u testua fillimisht në Njësinë Administrative Shëngjin, përfshirë prezantimin e projektit tek komuniteti lokal dhe organizimin e fushatave sensibilizuese.
- **Monitorimi dhe përmirësimi (3 vjet)** Projekti u monitorua rregullisht nga Drejtoria e Shërbimeve dhe ekspertë të jashtëm, duke bërë përmirësime të vazhdueshme për të siguruar efektivitetin.
- **Vlerësimi dhe replikimi (vazhdimisht)** Pas disa vitesh monitorimi dhe suksesi, bashkia filloi të planifikojë replikimin e praktikës në zona të tjera.

Për të arritur zbatimin me sukses të praktikë u ndërmorën disa masa organizative:

- **Strukturimi:** Projekti u strukturua në faza të qarta me afate kohore dhe përgjegjësi specifike për çdo fazë.
- **Angazhimi i komunitetit:** U organizuan takime dhe fushata informuese për të edukuar dhe angazhuar komunitetin për rëndësinë e praktikës së re.
- **Monitorimi dhe vlerësimi:** Një sistem i rregullt monitorimi u vendos për të vlerësuar efektivitetin e praktikës dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme bazuar në përgjigjen nga komuniteti dhe analizat e ekspertëve.
- **Replikimi:** Pas suksesit të pilotimit, bashkia filloi procesin e replikimit të praktikës në njësi të tjera, duke adaptuar qasjen sipas specifikave të secilës zonë dhe mësimet e nxjerra nga pilotimi.

Palët e interesuara dhe partnerët

Në procesin e zbatimit të praktikës së mbledhjes së mbeturinave derë më derë dhe hedhjes në kontenierë në orare të caktuara, janë përfshirë këta aktorë me rol të veçantë dhe bashkëpunim të koordinuar, që kanë luajtur një rol kritik në suksesin e praktikës, për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mjedisit.

- **Qytetarët dhe Biznesi lokal: Roli:** Respektimi i vendimit për të hedhur mbeturinat në oraret e caktuara ose për t'i lënë gjatë orareve të përcaktuara në prag të shtëpisë/biznesit për grumbullim. **Përparësitë:** Ndhmon në zvogëlimin e mbushjes së kontenierëve dhe në përmirësimin e mjedisit lokal.
- **Kompania private e mbeturinave: Roli:** Kryen grumbullimin, evadimin dhe transportin e mbeturinave në orarin e përcaktuar nga bashkia. **Përparësitë:**

Siguron që mbeturinat të trajtohen në mënyrë efikase dhe të parandalohet tejmbushja e kontenierëve.

- **Punëtorët e Bashkisë:** **Roli:** Realizojnë fshirjen, larjen dhe dezinfektimin e mjediseve publike në oraret e caktuara, përfshirë zonat rreth kontenierëve. **Përparësitë:** Përmirësojnë higjienën dhe estetikën e mjediseve urbane.
- **Punonjësit e Administratës së Bashkisë:** **Roli:** Koordinojnë dhe monitorojnë vazhdimisht zbatimin e praktikës së mbledhjes së mbeturinave. **Përparësitë:** Sigurojnë që operacioni të funksionojë efikas dhe të mbahet nën kontroll.
- **Ekspertët Mjedisorë:** **Roli:** Kontribuojnë në përlllogaritjen e kostove, modelet e monitorimit dhe ofrojnë mundësi për replikim të praktikave të suksesshme. **Përparësitë:** Mundësojnë që projekti të jetë më i qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për mjedisin.

Përfituesit

Përpjekjet dhe angazhimi i bashkisë janë përqendruar në sigurimin e një praktike të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, duke kontribuar në një mjedis më të qëndrueshëm dhe një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë për të gjithë qytetarët. Përfituesit e praktikës përfshijnë:

- **Qytetarët dhe Bizneset:** Mundësia për të hedhur mbeturinat në oraret e përcaktuara ul konfliktin dhe tensionin përreth tejmbushjes së kontenierëve, duke siguruar një mjedis më të pastër dhe më tërheqës.
- **Komuniteti lokal:** Reduktimi i ndotjes mjedisore dhe përmirësimi i pamjes së përgjithshme të mjedisit urban, duke krijuar një atmosferë më të këndshme për jetën dhe veprimtaritë e përditshme të biznesit dhe të qytetarëve.
- **Turistët:** Përmirësimi i pamjes së qytetit dhe zonave turistike, duke rritur kënaqësinë e vizitorëve.
- **Bizneset lokale:** Reduktimi i aromave dhe ndotjes që mund të lidhen me kontenierët e mbeturinave, duke krijuar një ambient më të këndshëm dhe më të shëndetshëm për klientët dhe punonjësit e bizneseve lokale.
- **Bashkia dhe Administrata lokale:** Përmirësimi i efikasitetit të shërbimit të mbledhjes së mbeturinave dhe reduktimi i kostove administrative për menaxhimin e mbetjeve, duke siguruar një administrim më të lehtë dhe të qëndrueshëm të shërbimit.

Në lidhje me grupet e marginalizuara dhe përfshirjen sociale:

- Përfshirja e komuniteteve të varfra dhe të marginalizuara në skudrën e fshirjes dhe pastrimit të plazheve publike, mundëson kushte të përshtatshme dhe një mjedis më të pastër pune. Grumbullimi derë më derë siguron mundësi më të shumta për material të pastër riciklimi, mundësi më të shumta për biznes të kësaj kategorie.
- Praktika ka integruar çështjet gjinore duke siguruar qasje të barabarta dhe pjesëmarrje të të dy gjinive në zbatimin dhe përfitimin nga shërbimet e mbledhjes së mbeturinave. Kjo përfshirje përmirëson gjithashtu kuptimin dhe përdorimin e barabartë të shërbimeve dhe infrastrukturës nga të gjitha pjesëtarët e komunitetit.

Mjetet dhe burimet

Për krijimin dhe zbatimin e praktikës së mbledhjes së mbeturinave derë më derë dhe hedhjes në orare të caktuara, janë përdorur mjetet dhe burimet në vijim:

1. Mjetet dhe teknologjitë për grumbullimin derë më derë: Për grumbullimin e mbeturinave derë më derë në zonën turistike, janë përdorur 3 mjete transporti me kapacitet për të transportuar deri në 10 ton mbeturina. Këto mjete punojnë 7 ditë në javë në regjimin me dy turne gjatë periudhës turistike 90-ditore.
2. Përdorimi i qeseve të mbeturinave: Për secilin biznes, janë përdorur qese mbeturinash me kapacitet 60L për të lehtësuar grumbullimin dhe hedhjen e mbeturinave në oraret e caktuara. Këto qese janë të përdorura në mënyrë të përshtatshme për nevojat specifike të çdo biznesi dhe për të siguruar që mbeturinat të jenë të vendosura dhe të grumbulluara në mënyrë efektive. Në secilën prej këtyre qeseve, bashkia ka vendosur logo, mesazhe sensibilizues dhe oraret e grumbullimit.
3. Monitorimi dhe koordinimi i veprimtarisë: Bashkia ka përdorur sisteme të monitorimit dhe koordinimit për të siguruar që grumbullimi dhe heqja e mbeturinave të bëhet në oraret e përcaktuara dhe në mënyrë të koordinuar me nevojat e komunitetit dhe të bizneseve.
4. Sensibilizimi dhe edukimi i komunitetit me fushata informuese dhe edukative: Janë organizuar fushata sensibilizuese dhe edukative për qytetarët dhe bizneset lokale në lidhje me rëndësinë e grumbullimit të mbeturinave në orare të caktuara dhe përfitimet e kësaj praktike për mjedisin dhe për komunitetin në përgjithësi. Materiale të tilla si njoftime, fletëpalosje apo postera janë shpërndarë, ndërkohë që banderolat apo mesazhet në ekrane LED kanë qenë të pranishme në ambientet e plazheve apo qyteteve të Shëngjinit dhe Lezhës. Sensibilizimi ka vijuar edhe me përdorimin e logove dhe mesazheve në qeset plastike dhe në mjetet e grumbullimit të mbetjeve.

Përdorimi i këtyre mjeteve dhe teknologjive ka ndihmuar në implementimin efikas dhe të suksesshëm të praktikës së mbledhjes së mbeturinave derë më derë dhe hedhjes në orare të caktuara në zonën e studiuar. Pas periudhës së pilotimit, do të vazhdojë vlerësimi dhe plotësimi i nevojave të mundshme për të optimizuar dhe zgjeruar këtë praktikë në mënyrë që të përballohen sfidat dhe të maksimizohet impakti pozitiv në mjedis dhe komunitet.

Buxheti / Kostot

Kostoja e zhvillimit dhe zbatimit të praktikës së mbledhjes së mbeturinave derë më derë dhe hedhjes në orare të caktuara është përafërsisht 350,000 euro në vit, kosto kjo e ngjashme me koston e grumbullimit tradicional (ofrimit të shërbimit me grumbullimin në pika publike me kazanë 1.1m³). Kjo shifër përfshin shpenzimet për organizimin e pilotimit, implementimin e praktikës në terren, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e saj. Mirëmbajtja është përfshirë në këtë buxhet të përgjithshëm. Kostot e mirëmbajtjes së praktikës përfshijnë shpenzimet për operacionet e përditshme të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave, si dhe për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive. Në këtë rast, kostot e karburantit për mjetet e grumbullimit janë të përfshira, ndërsa kostot e qeseve të mbeturinave janë mbuluar nga bizneset dhe qytetarët që përdorin shërbimin. Në të ardhmen, synohet që kostoja e praktikës të

ulet edhe më shumë duke zbatuar skema të përshtatshme për mbledhjen e diferencuar të mbeturinave. Kjo parashikohet të përfshijë edhe më tej reduktimin e numrit të kontenerëve dhe përdorimin e skemave të riciklimit për të përfshirë më shumë mbeturina në ekonominë qarkulluese. Këto masa parashihen të ulin kostot dhe të përmirësojnë efikasitetin e përgjithshëm të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave urbane.

Mbështetje nga institucione/projekte/konsulentë të jashtëm

Praktika e mbledhjes së mbeturinave derë më derë dhe hedhjes në orare të caktuara është ideuar dhe zbatuar tërësisht nga stafi i bashkisë në bashkëpunim me kompaninë private të specializuar në grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave urbane. Nuk ka pasur mbështetje të jashtme financiare apo teknike për krijimin ose zbatimin e kësaj praktike.

Ndikimi

Praktika e mbledhjes së mbeturinave derë më derë dhe hedhjes në orare të caktuara ka pasur një ndikim pozitiv dhe është vlerësuar si një praktikë e mirë për shkak të disa faktorëve të rëndësishëm:

1. Ndikimi dhe avantazhet e praktikës:
 - *Mbështetje mjedisore:* Redukton ndotjen mjedisore dhe përmirëson pastërtinë e qytetit duke parandaluar tejmbushjen e kontenerëve dhe përhapjen e mbeturinave në hapësirat publike.
 - *Efikasitet i lartë:* Organizon grumbullimin e mbeturinave në orare të caktuara, duke lehtësuar logjistikën dhe përmirësuar koordinimin midis bashkisë, komunitetit dhe kompanisë private të shërbimit.
2. Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve publike: Ul koston e administrimit dhe menaxhimit të mbeturinave, pasi kontrollon dhe rregullon procesin e grumbullimit dhe trajtimit të tyre. Përmirëson cilësinë e shërbimit të pastrimit dhe menaxhimit të mbeturinave, duke siguruar që operacionet të jenë më efikase dhe më të përshtatshme për nevojat e komunitetit.
3. Reduktimi i kostove: Praktika ka kontribuar në reduktimin e kostove të administratës lokale për menaxhimin e mbetjeve urbane, duke rregulluar procesin dhe duke reduktuar mbingarkesat dhe shpenzimet e panevojshme.
4. Gjenerimi i më shumë të ardhurave: Në rastin e praktikës së mbledhjes së mbetjeve urbane, nuk ka një rritje të drejtë të më shumë të ardhurave, por ka një potencial për kursim të kostove për shërbimin dhe për të tërhequr te mbeturat deri të në vlerat.
5. Efektet afatshkurtra dhe afatgjata: Në afate shkurtra, praktika ka sjellë një ndryshim të menjëhershëm në organizimin dhe efikasitetin e shërbimeve të pastrimit dhe menaxhimit të mbeturinave, duke rregulluar logjistikën dhe koordinimin e nevojave të përdoruesve. Në afatgjatësi, praktika pritet të vazhdojë të sjellë përfitime në qëndrueshmërinë mjedisore dhe në kursimin e kostove për administratën publike, duke optimizuar më tej proceset dhe duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve për komunitetin.

Këto aspekte e bëjnë praktikën e mbledhjes së mbeturinave derë më derë dhe hedhjes në orare të caktuara një zgjidhje efektive dhe të qëndrueshme për menaxhimin e mbeturinave urbane në komunitete të ndryshme.

Qëndrueshmëria

Për të mirëmbajtur qasjen e mbledhjes së mbeturinave derë më derë dhe hedhjes në orare të caktuara dhe për të siguruar që të jetë një zgjidhje afatgjatë dhe e qëndrueshme, janë ndërmarrë disa masa dhe veprime:

1. Monitorimi dhe vlerësim i vazhdueshëm: Është vendosur një sistem të vazhdueshëm monitorimi për të vlerësuar efektivitetin e praktikës dhe për të identifikuar çdo problem që mund të dalë gjatë implementimit. Kjo përfshin analizën e performancës së shërbimit, maturimin e nivelit të përdorimit të komunitetit, dhe vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social të praktikës.
2. Komunikim dhe edukim i vazhdueshëm: Për të mbajtur pjesëmarrjen dhe mbështetjen e komunitetit, është organizuar një komunikim të vazhdueshëm dhe fushata edukative. Kjo përfshin takime periodike me banorët, informimin rreth rregullave të praktikës dhe rëndësisë së respektimit të orareve të caktuara për hedhjen e mbeturinave.
3. Përmirësim i infrastrukturës dhe teknologjisë: Nëse ka nevojë, janë bërë investime për përmirësimin e infrastrukturës së grumbullimit të mbeturinave dhe për implementimin e teknologjisë së avancuar për monitorimin dhe menaxhimin e procesit.
4. Adaptimi dhe rishikimi i politikave: Politikat dhe udhëzimet për praktikën janë rishikuar dhe përditësuar sipas nevojave të ndryshme dhe mësimëve të nxjerra nga vlerësimet periodike. Ky proces siguron që praktika të jetë e përshtatshme dhe e efektshme në të gjitha aspektet e saj në një kontekst afatgjatë.
5. Përmbajtja e bashkëpunimit institucional: Ka një bashkëpunim të vazhdueshëm me partnerët dhe palët e interesuara, përfshirë kompaninë private për grumbullimin e mbeturinave, qytetarët dhe bizneset. Si dhe partner të tjerë si organizata apo ekspertë të specializuar, për të siguruar që të gjithë aktorët përfshihen dhe bashkëpunojnë në mënyrë efektive për implementimin dhe mirëmbajtjen e praktikës.

Sigurimi që praktika të jetë një zgjidhje afatgjatë dhe e qëndrueshme kërkon përqendrim në aspektet e mësipërme për të siguruar që ajo të përballet me sfidat aktuale dhe të ardhmen, duke kontribuar në përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë së jetës dhe mjedisit të komunitetit.

Mësime të nxjerra

Përveç aspekteve të diskutuara më sipër, ka disa mësimet dhe sugjerime, të cilat mund të ndihmojnë bashkitë e tjera në implementimin e praktikave të ngjashme të mbledhjes së mbeturinave dhe menaxhimit të mjedisit:

1. **Përfshirja e komunitetit është kyç**: Një nga mësimet kryesore është se përfshirja e qytetarëve dhe bizneseve në proces është shumë e rëndësishme. Informimi dhe edukimi i tyre për rëndësinë e respektimit të orareve të caktuara

për hedhjen e mbeturinave ka ndihmuar në rritjen e përkrahjes dhe respektimit të rregullave.

- 2. Monitorimi i vazhdueshëm dhe rregullimi sipas nevojave:** Është e rëndësishme të keni një sistem të vazhdueshëm monitorimi për të vlerësuar efektivitetin e praktikës dhe për të identifikuar çdo problem që mund të dalë. Rregullimi i politikave dhe udhëzimeve sipas rezultateve të monitorimit dhe rekomandimeve të ekspertëve është çelësi për suksesin afatgjatë.
- 3. Bashkëpunimi i mirë me kompanitë private dhe ekspertët e fushës:** Bashkëpunimi i ngushtë dhe i efektshëm me kompanitë private që ofrojnë shërbime të ngjashme dhe me ekspertët e mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave është esenciale për sigurimin e një zbatimi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të praktikës.

Aspekte që bien në sy në veçanti:

- **Efikasiteti dhe kostot:** Një aspekt që ka bërë që ky projekt të dalë në vëmendje është rritja e efikasitetit të shërbimeve publike dhe reduktimi i kostove administrative për menaxhimin e mbeturinave. Kjo ka pasur një impakt pozitiv në financat publike dhe në përmirësimin e shërbimit për qytetarët.
- **Përfshirja sociale:** Fokusi në përfshirjen e komuniteteve të marginalizuara dhe në sigurimin që të gjithë të kenë akses në shërbimet e ofruara nga praktika, ka ndihmuar në rritjen e përkrahjes dhe në përmirësimin e përgjithshëm të klimës sociale në komunitet.

Sugjerime specifike për bashkitë e tjera:

- **Të bëni:** Investoni në një analizë të qëndrueshme të kostos dhe të përfitimeve përpara se të filloni një projekt të tillë. Identifikoni burimet potenciale të financimit dhe siguroni mbështetjen e nevojshme nga autoritetet lokale dhe qytetarët.
- **Të mos bëni:** Mos e neglizhoni përfshirjen dhe informimin e komunitetit në proces. Komunikimi transparent dhe edukimi i qytetarëve janë thelbësore për suksesin e praktikave të këtylla.

Zbatimi i praktikave të mira të mjedisit dhe menaxhimit të mbeturinave është një sfidë e rëndësishme dhe e nevojshme për të gjitha bashkitë. Me përqendrim dhe përgjegjshmëri të duhur, këto praktika mund të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe të mjedisit për të gjithë qytetarët.

Lidhje të përdorshme

Në lidhje me praktikën e mirë të mbledhjes së mbeturinave derë më derë dhe hedhjes në orare të caktuara, mund të konsiderohen disa burime të rëndësishme dhe relevante përkatës:

Raporte dhe udhëzues të organizatave ndërkombëtare: Projekte të tilla si “Bashkitë për në Evropë” apo “BE për Bashkitë” (EU4M) të Bashkimit Evropian, Projekti “Bashki të Forta” i SDC-së i zbatuar nga Helvetas, organizata si GIZ apo KFW, kanë studiuar praktikën dhe e njohin atë si një praktikë të mirë.

Rrjetet dhe platformat e shkëmbimit të përvojave: Gjithashtu edhe raportet vjetore të Shoqatës për Autonomi Vendore (SHAV) apo Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit e kanë përshkruar këtë praktikë dhe kanë nxjerrë rekomandimet e tyre.

Kjo praktikë ka gjetur vëmendjen edhe të disa mediave në Shqipëri, si:

<https://www.youtube.com/watch?v=HxqYRtUhwsw>

https://www.youtube.com/watch?v=SZTG8zuz6_s

<https://www.youtube.com/watch?v=kJvbCLNCdbw>

Për më shumë informacione dhe për ndarjen e njohurive kontaktoni:

Z. Indrit Torba

Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Bashkia Lezhë

Email: indrit.torba@gmail.com

Cel: +355 69 23 77 447